

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8381
E martë, 8 shtator 2026
Çmimi 0.50 €

95 për qind e problemeve
me të cilat përballen
aktualisht komunat janë
shkakuar nga qeveritë

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PDK-ja DHE LDK-ja DO TË MARRIN PJESË NË SEANCËN KONSTITUIVE TË KUVENDIT MË 9 SHTATOR

FAQE 4-5



Deputetët e zgjedhur pritet të
mblidhen më 9 shtator për
vazhdimin e seancës
konstituive të Kuvendit të
Kosovës në përpjekje për t'i
formuar institucionet e reja të

vendit pas zgjedhjeve të
qershorit. Partia Demokratike e
Kosovës (LDK) dhe Lidhja
Demokratike e Kosovës (LDK)
kanë konfirmuar pjesëmarrjen
në vazhdimin e seancës

konstituive të Kuvendit të
Kosovës. Kryetari i PDK-së,
Bedri Hamza, nuk e ka
përfshirë mundësinë që edhe
kjo seancë të jetë lojë politike e
Lëvizjes Vetëvendosje

AKTUALE



INFORMACION, BURIME, NDIKIM:
GJURMËT E BIA-S NË KOSOVË F. 4-5

SHBA-JA RINIS PËRPJËKJET
PËR PAQE NË UKRAINË, POR
ISH-AMBASADORËT NUK SHOHIN
PËRPARIM F. 2

PROKURORIA: SHEHOLLI KA
ZBATUAR NJË PLAN KONKRET QË
SYNONTË DËMTIMIN E INTERESAVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS F. 5

EKONOMI



SHAHINI TAKON NË PARIS
SENATORËT MEIGNEN
DHE SZPINER F. 7

RAHOVECI SHKËLQEU NË "HARDH
FEST 2026" F. 7

SPORT



MALISHEVA, LIDERE E SUPERLIGËS
NË FUTBOLL F. 11



*Shqipe
Krasniqi*

27 vite shërbim
në Policinë e
Republikës së
Kosovës!

NJË FLETËZ NË 27-VJETORIN E THEMELIT TË SHËRBITIT
POLICOR TË KOSOVËS (SHPK) MË 6 SHTATOR 1999

SHQIPE KRASNIQI DHE SHQIPET E TJERA MERITOJNË MË SHUMË VLERËSIM

- Në një familje me 11 burra u rrit një vajzë.
E vetmja, por jo e brishta

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-JA RINIS PËRPJEKJET PËR PAQE NË UKRAINË, POR ISH-AMBASADORËT NUK SHOHIN PËRPARIM

WASHINGTON, 7 SHTATOR - Administrata Trump ka ringjallur përpjekjet diplomatike për t'i dhënë fund luftës së Rusisë në Ukrainë, ndërsa të dërguarit amerikanë Steve Witkoff dhe Jared Kushner udhëtuan nga Moska në Kiev në një përpjekje të profilit të lartë për t'i hapur rrugë një raundi tjetër negociatash. Por, pas takimeve të ndara me presidentin rus Vladimir Putin dhe presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky, pyetja kryesore mbetet pa përgjigje: A ka ndryshuar mjaftueshëm qëndrimi i Moskës për ta bërë të mundur një marrëveshje?

Tre ish-ambasadorë amerikanë në Ukrainë, të intervistuar nga Radio Evropa e Lirë më 6 shtator, thanë se, për momentin, përgjigjja duket se është jo.

Fundjava shënoi herën e parë që Witkoff dhe Kushner udhëtuan së bashku në Kiev për bisedime me Zelenskyn, pasi një ditë më parë ishin takuar me Putinin në Moskë. Witkoff i përshkroi diskutimet në të dyja kryeqytetet si konstruktive dhe tha se Uashingtoni kishte dëgjuar “ide të reja” nga Moska. Kushner tha se Shtetet e Bashkuara po punonin për një “paketë më të gjerë paqeje”.

Zelensky, nga ana e tij, i cilësoi diskutimet me amerikanët si “shumë substanciale” dhe tha se Ukraina ishte e gatshme të ecte përpara drejt bisedimeve trepalëshe mes Kievit, Uashingtonit dhe Moskës. Këshilltarët e sigurisë kombëtare të Britanisë, Francës dhe Gjermanisë, gjithashtu morën pjesë në një pjesë të diskutimeve në Kiev.

Aktiviteti diplomatik është domethënës, por ish-ambasadorë paralajmërojnë kundër ngatërimit të lëvizjes me përparimin.

William B. Taylor Jr., i cili ka shërbyer dy herë si ambasador i ShBA-së në Ukrainë, tha se vizita në Kiev ishte “lajm i mirë”, por argumentoi se testi kryesor qëndron diku tjetër. “Problemi i vërtetë në diplomaci nuk është Kiev. Problemi i vërtetë në diplomaci nuk është Uashingtoni. Problemi i vërtetë në diplomaci është Moska”, i tha Taylor Radios Evropa e Lirë.

Ai tha se nuk kishte dëgjuar asgjë nga Kremli që të sugjeronte se Putini ishte larguar nga kërkesat e tij maksimaliste.

John E. Herbst, i cili e pasoi Taylorin si ambasador nën presidentin George W. Bush, ofroi një vlerësim të ngjashëm. Ai tha se përpjekja aktuale mund të jetë nisma më e rëndësishme diplomatike e SHBA-së prej muajsh, thjesht sepse që nga janari kishte pasur pak aktivitet të ngjashëm. Por, shtoi ai, “pyetja është: A ka diçka serioze këtu?



Dhe, përgjigjja është: Nuk e dimë”. Kjo pasiguri ka gjasë të dominojë fazën e ardhshme të diplomacisë. Geoffrey Pyatt, i cili shërbeu ambasador i ShBA-së në Ukrainë nga viti 2013 deri më 2016, gjithashtu e mirëpriti angazhimin e ripërtërirë amerikan, duke paralajmëruar se pengesa themelore mbetet gatishmëria e Rusisë për t'i ulur tensionet.

Pjesa që mungon

Pretendimi më intrigues që doli nga fundjava është deklarata e Witkoffit se amerikanët kishin dëgjuar “ide të reja” në Moskë. As ai as Kushneri nuk kanë shpjeguar publikisht se cilat janë ato ide. Kjo lë një dallim thelbësor mes një gjuhe të re dhe një qëndrimi të ri rus.

Për Taylorin, testi do të ishte një ulje konkrete e intensitetit ushtarak. Një marrëveshje ruse për një armëpushim përgjatë vijave aktuale, ndalimi i sulmeve me rreze të gjatë, përfundimi i sulmeve ndaj infrastrukturës energjetike dhe një mirëkuptim për transportin detar do të përbënin një largim të vërtetë nga qëndrimi aktual i Moskës, tha ai. Pa hapa të tillë, fjala “e re” rrezikon të përshkruajë propozime që vetëm riformulojnë kërkesat ekzistuese të Rusisë.

Herbst gjithashtu iu referua një historie pritshmërisht të papërmbushura. Zyrtarët amerikanë më parë kanë sugjeruar se Moska ishte e gatshme të bënte kompromis, vetëm që përmbajtja e këtyre kompromiseve të supozuara të mbetej e paqartë ose të mos materializohej.

Kjo histori i bën veçanërisht të rëndësishme detajet e takimeve të kësaj fundjave. Një zyrtar i lartë i administratës amerikane, i informuar për vizitën, i tha Radios Evropa e Lirë se Uashingtoni mbetet i gatshëm dhe optimist për mundësinë e një raundi tjetër negociatash mes Moskës dhe Kievit.

Zyrtari tha se administrata do t'i vlerësojë rezultatet e takimeve të të dërguarve përpara se t'i përcaktojë hapat konkretë të

ardhshëm, ndërsa javët në vijim do të jenë të rëndësishme për hartimin e një udhërrëfyesi më të hollësishëm.

Zyrtari, gjithashtu, përmendi Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së si një mundësi potencialisht e dobishme për vazhdimin e punës, duke thënë se ajo mund t'u mundësojë palëve “të vazhdojnë aty ku Jared dhe Steve e kanë lënë” gjatë fundjavës.

Territori dhe siguria mbeten çështje kyçe

Referimi i Kushnerit ndaj një “pakete më të gjerë paqeje” ngre pyetjen se çfarë do të përmbante në të vërtetë një paketë e tillë. Përgjigjet e ish-ambasadorëve përqendrohen rreth dy çështjeve themelore: territorit dhe sigurisë së ardhshme të Ukrainës.

Rusia dhe Ukraina mbeten shumë larg njëra-tjetrës për çështjen e territorit. Moska ka kërkuar lëshime territoriale nga Ukraina, të cilat Kiev i ka refuzuar, ndërsa Ukraina vazhdon ta konsiderojë tokën e pushtuar nga Rusia si territor sovran ukrainas.

Taylor propozoi një mënyrë të mundshme për ta ndarë realitetin e menjëhershëm në terren nga mosmarrëveshja ligjore e pazgjidhur.

Ukraina dhe partnerët e saj perëndimorë, sugjeroi ai, mund ta pranojnë faktin se Rusia kontrollon rreth 19 për qind të territorit ukrainas, pa e njohur këtë kontroll si legjitim ose të përhershëm në aspektin ligjor.

Në një kuadër të tillë, mosmarrëveshja territoriale do të ngrihej përkohësisht, në vend që të zgjidhej. Rusia do ta ruante kontrollin de facto, ndërsa do të hiqte dorë nga kërkesat për njohje ndërkombëtare të sovranitetit të përhershëm rus mbi territoret e pushtuara.

Por, Taylor theksoi se nuk ka asnjë shenjë se Putini është i gatshëm ta pranojë një gjë të tillë.

Vetë Zelensky ka thënë se çështja territoriale mbetet e pazgjidhur dhe përfundimisht kërkon vendime në nivelin më të lartë politik.

Herbst e sheh çështjen në një

këndvështrim më të gjerë, duke argumentuar se objektivat e Putinit shkojnë përtej territorit. Sipas vlerësimit të tij, Kremli kërkon kontroll të konsiderueshëm mbi territorin dhe drejtimin politik të Ukrainës – objektiva që do të ishin të papajtueshme me një marrëveshje të qëndrueshme të bazuar në sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

Armëpushimi ende larg paqes

Dallimi mes përfundimit të luftimeve dhe zgjidhjes së luftës po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Taylor tha se hapi i parë drejt një marrëveshjeje të qëndrueshme duhet të jetë një armëpushim gjithëpërfshirës që mbulon tokën, ajrin dhe detin.

Herbst, gjithashtu, argumentoi për një armëpushim përgjatë vijave ekzistuese, të shoqëruar me garanci sigurie dhe një përpjekje për rindërtim që do ta linte Ukrainën ekonomikisht dhe ushtarakisht të aftë për t'u mbrojtur.

Çështja e sigurisë mund të rezultojë përfundimisht edhe më e rëndësishme se territori.

Kievi ka kërkuar vazhdimisht garanci mjaftueshëm të forta për ta penguar Rusinë që të sulmojë sërish pas çdo marrëveshjeje. Taylor tha se një marrëveshje e besueshme mund të përfshinte trupa evropiane të dislokuara në Ukrainë, nën një koalicion të vendeve të gatshme, me mbështetjen e ShBA-së përmes fuqisë ajrore, inteligjencës dhe kapaciteteve të tjera.

Ai, gjithashtu, përmendi integrimin e ardhshëm të Ukrainës në Bashkimin Evropian dhe, në fund, në NATO, si elemente afatgjatë të sigurisë së saj.

Kjo do të kërkonte angazhime të konsiderueshme nga Perëndimi në një kohë kur Uashingtoni ka treguar ngurrim për të marrë përsipër detyrime ushtarake pa afat.

Për Ukrainën, pra, një armëpushim pa një parandalim të besueshëm mund të krijojë vetëm një pauzë para një lufte tjetër. Për Rusinë, ndërkohë, garanci të tilla perëndimore mund të jenë pikërisht ajo që Moska kërkon të parandalojë.

Evropa i afrohet tryezës së negociatave

Pjesëmarrja e këshilltarëve të sigurisë kombëtare të Britanisë, Francës dhe Gjermanisë në bisedimet në Kiev ishte një nga zhvillimet më të rëndësishme të fundjavës.

Witkoff tha se prania e tyre

dëshmonte se “bashkëpunimi është thelbësor” për arritjen e një marrëveshjeje.

Taylor shkoi edhe më tej, duke argumentuar se përfshirja evropiane është thelbësore, sepse vendet evropiane ka të ngjarë të jenë ofruesit kryesorë të çdo marrëveshjeje sigurie për Ukrainën. Evropa është, gjithashtu, një burim i madh i ndihmës financiare dhe ushtarake për Kievin.

Për momentin, evropianët duket se janë përfshirë në konsultime, në vend që t'u jetë dhënë një rol formal negociues. Nëse kjo do të ndryshojë, do të varet në masë të madhe nga ajo që Uashingtoni do të vendosë përfundimisht në tryezë dhe nga ajo që Moska është e gatshme të pranojë.

Diplomacia po zhvillohet gjithashtu në sfondin e luftimeve të vazhdueshme dhe, në disa aspekte, të shtuara. Ky hendek në mes të angazhimit diplomatik dhe sjelljes në fushëbetejë është domethënës.

Nëse Moska dhe Kiev nuk mund të ruajnë as një përmbajtje të kufizuar ushtarakë gjatë zhvillimit të bisedimeve, arritja e një marrëveshjeje për një armëpushim gjithëpërfshirës do të jetë dukshëm më e vështirë. Kjo, gjithashtu, ofron një test praktik për vullin e pretenduar diplomatik.

Testi është Moska

Ukraina tashmë ka sinjalizuar se është e gatshme për një takim tjetër trepalësh. Zelensky tha se Kiev dëshiron të bëjë gjithçka që është e mundur për të realizuar një takim mes Ukrainës, ShBA-së dhe Rusisë, por ende nuk ka asnjë tregues të qartë publik se Putini ka rënë dakord për një takim të tillë.

Për Taylorin ky është pikërisht standardi i menjëhershëm. “Ajo që duhet të dëgjojmë është ‘po’”, tha ai - një tregues i qartë nga Putini ose Kremli se Moska është e gatshme të takohet me Zelenskyn dhe presidentin amerikan.

Herbst tha se testi i parë në ditët në vijim do të jetë nëse hollësitë e asaj që u diskutua në Moskë dhe Kiev do të fillojnë të bëhen publike, si dhe mënyra se si Uashingtoni, Kiev dhe Moska do t'u përgjigjen atyre.

Siç tha Pyatt, ish-ambasadori amerikan që shërbeu në Kiev gjatë viteve të para të luftës së Rusisë, angazhimi i ripërtërirë diplomatik amerikan është i mirëpritur, por problemi themelor mbetet gatishmëria e Putinit për t'i ulur tensionet dhe kuptimi i tij për atë që ukrainasit duan për të ardhmen e vendit të tyre.

PDK-ja DHE LDK-ja DO TË MARRIN PJESË NË SEANCËN KONSTITUIVE TË KUVENDIT MË 9 SHTATOR

Deputetët e zgjedhur pritet të mblidhen më 9 shtator për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës në përpjekje për t'i formuar institucionet e reja të vendit pas zgjedhjeve të qershorit. Partia Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë konfirmuar pjesëmarrjen në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, nuk e ka përjashtuar mundësinë që edhe kjo seancë të jetë lojë politike e Lëvizjes Vetëvendosje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Deputetët e zgjedhur pritet të mblidhen më 9 shtator për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës në përpjekje për t'i formuar institucionet e reja të vendit pas zgjedhjeve të qershorit dhe për t'i dhënë fund krizës pothuajse dyvjeçare politike. Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Jehona Lushaku-Sadriu, ka konfirmuar të hënën se grupi parlamentar i LDK-së do të marrë pjesë në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Pas mbledhjes së grupit parlamentar, Lushaku-Sadriu tha se deputetët e LDK-së kanë vendosur të marrin pjesë në seancë dhe të kontribuojnë në konstituimin e Kuvendit. “Vendosëm si grup që të marrim pjesë në këtë seancë dhe t'i kontribuojmë konstituimit të Kuvendit, meqë Kosova është në një fazë të rëndësishme për themelimin e institucioneve dhe funksionalitetin e tyre”, deklaroi ajo. Sipas saj, LDK-ja ka bërë thirrje vazhdimisht që

Kuvendi të konstituohet sa më shpejt dhe institucioneve të vendit t'u rikthehet funksionaliteti. “Ne dëshirojmë që sa më parë Kosovës t'i kthehen institucionet dhe të bëhen institucione funksionale. Mos harroni, Kosova është në një krizë politike, pa institucione të fuqiplota, përkundër faktit që kemi shkuar tri herë në zgjedhje. Dhe kjo është e papranueshme”, tha Lushaku-Sadriu. E pyetur nëse gjatë mbledhjes së grupit parlamentar është diskutuar për zgjedhjen e presidentit dhe nëse LDK-ja ka ndryshuar qëndrim për këtë çështje, ajo tha se kjo temë nuk është diskutuar. “Çështja e presidentit absolutisht nuk është diskutuar, sepse nuk është temë. Temë është seanca dhe konstituimi i Kuvendit të Kosovës”, u shpreh ajo. Lushaku-Sadriu përsëriti qëndrimin e LDK-së se Kuvendi duhet të konstituohet sa më parë në mënyrë që vendi të ketë institucione funksionale. Pas LDK-së, edhe grupi parlamentar i PDK-së ka mbajtur takim. Pas këtij takimi, lideri i saj, Bedri Hamza, ka bërë me dije se do të marrin

pjesë në seancën konstituive të Kuvendit më 9 shtator. Hamza nuk e ka përjashtuar mundësinë që edhe kjo seancë të jetë lojë politike e Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka thënë se gjatë diskutimeve të zhvilluara ka pasur një konstatim të qartë se Kushtetuta e Kosovës është shkelur, duke përmendur edhe mosrespektimin e një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese. “Ka pasur diskutime të hapura, shumë përmbajtjesore, me një konstatim që Kushtetuta e Kosovës është shkelur. Është shkelur aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese. Është aktgjykim që sqaron qartë që Kuvendi duhet të konstituohet 30 ditë pas certifikimit të rezultatit zgjedhor. Kjo nuk ka ndodhur”, ka deklaruar Hamza pas mbledhjes së grupit parlamentar të kësaj partie. Ai ka kritikuar edhe vonesën në thirrjen e seancës, duke thënë se nuk ka pasur arsytim juridik apo faktik përse ajo nuk është thirrur më herët. “Edhe pse Kurti e ka ditur këtë çështje, kanë vazhduar me interpretimet e tyre. Nuk ka asnjë arsytim apo shpjegim faktik, logjik, juridik pse seanca nuk u thirr më herët, por me datën 9”, është shprehur ai. Sipas

Hamzës, edhe pjesëmarrja në seancën e 9 shtatorit nuk garanton se procesi do të përfundojë me konstituimin e Kuvendit. “Edhe kjo mund të jetë një ftesë që mund të mos konstituohet Kuvendi, pra për të bërë veprime dhe lojëra të tjera politike. PDK-ja do të jetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës”, ka thënë kreu i PDK-së. Sipas një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet 30 ditë nga certifikimi i rezultatit zgjedhor. Ky afat ka skaduar më 7 gusht. Seanca konstituive - që nisi më 6 gusht - është caktuar të vazhdohet më 9 shtator nga kryesuesi i saj, Avni Dehari, nga Lëvizja Vetëvendosje. Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit më herët kishte argumentuar se afati 30-ditor vlen nga nisja e seancës, pra nga 6 gushti dhe ky afat, sipas këtij interpretimi, skadon sot. Ndërkaq, deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka shkruar në rrjetet sociale se vendimi i Deharit që seanca të vazhdojë më 9 shtator është një “provokim i qëllimshëm” i cili, sipas tij, është, po ashtu, një veprim “që prodhon jostabilitet institucional”. Ai e ka akuzuar

LV-në se nuk e respektoi afatin kushtetues për konstituimin e Kuvendit por as, siç u shpreh ai, interpretimin e kësaj partie lidhur me afatin se kur duhet të konstituohet organi ligjvënës. LV-ja ka këmbëngulur se konstituimit të Kuvendit duhet t'i paraprijë një marrëveshje për çështjen e presidentit. Një marrëveshje në mes LV-së dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës për këtë temë u arrit më 31 gusht, por vetëm një ditë pas prezantimit të Bekim Sejdiut kandidat konsensual, gjashtë deputetë të LDK-së thanë se nuk kanë votë për të. Pas zhvillimeve në LDK, Kurti ka thënë se për Sejdiun janë 74 vota - të pamjaftueshme që ai të bëhet presidenti i gjashtë i Republikës së Kosovës, pasi për zgjedhjen e presidentit kërkohet pjesëmarrja në proces e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende. LV-ja ka 53 mandate, ndërsa LDK-ja 18. PDK-ja dhe Aleanca deri më tani kanë refuzuar të përfshihen në negociatën për çështjen e presidentit. Nëse deputetët nuk e zgjedhin presidentin e ri, atëherë Kosova do t'i mbajë zgjedhjet e katërta në më pak se dy vjet dhe të dytat për shkak të moskonsensusit për çështjen e kreut të shtetit.



INFORMACION, BURIME, NDIKIM: GJURMËT E BIA-s NË KOSOVË

Aktakuzat për spiunazh në Kosovë tregojnë se informacionet e dyshuara se janë mbledhur për BIA-n shtrihen nga siguria dhe institucionet te politika dhe individët me ndikim. Ekspertët thonë se synimi i shërbimeve të inteligjencës nuk është vetëm mbledhja e informacionit: burimet dhe rrjetet e krijuara mund të përdoren edhe për ndikim. Disa raste kanë përfunduar me dënime, të tjera janë ende në gjykim, ndërsa mbetet e paqartë se sa shtrihet aktiviteti i BIA-s në Kosovë

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Në pak më shumë se dy vjet, në Kosovë janë arrestuar disa persona nën dyshimin se kanë spiunuar për Agjencinë e Sigurisë dhe Informacionit të Serbisë, BIA. Të marra së bashku, rastet tregojnë një gamë të gjerë informacionesh për të cilat, sipas Prokurorisë Speciale, ka pasur interes: nga Policia e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), te zhvillimet politike, zgjedhjet, pjesëtarë të komuniteteve të caktuara dhe individë me ndikim. Disa prej rasteve janë ende në gjykim. Në disa të tjera tashmë ka dënime. Ato nuk provojnë vetvetiu ekzistencën e një operacioni të vetëm apo të një rrjeti të koordinuar të BIA-s në Kosovë. Por, ngrenë pyetjen se çfarë kërkon ajo dhe çfarë mund të bëjë me informacionet pasi t'i ketë siguruar. "Punohet më së shumti në përfitimin e njerëzve. Qoftë për informacione, qoftë për ndikim përmes institucioneve", thotë Dushan Janjiq, themelues i Forumit për Marrëdhënie Etnike në Beograd, për Radion Evropa e Lirë. Një prej rasteve më të fundit nisi të gjykohet më 7 shtator në

Gjykatën Themelore në Prishtinë. Fatmir Sheholli akuzohet për spiunazh dhe shantazh. Prokuroria Speciale e Kosovës pretendon se ai ishte rekrutuar nga BIA dhe se mblidhte informacione për zhvillimet politike, gjendjen e sigurisë dhe funksionimin e institucioneve të Kosovës. Sipas aktakuzës, ai dyshohet se ka marrë pjesë edhe në një plan për komprometimin e zyrtarëve të Kosovës dhe ndërhyrjen në zgjedhjet lokale të vitit 2025. Në telefonin e tij, sipas Prokurorisë, është gjetur edhe fotografia e një dokumenti të quajtur "Top sekret 2", përmbajtja e të cilit pretendon ekzistencën e një plani për përdorimin e fesë islame për përçarjen e shqiptarëve dhe ndryshimin e perceptimit të Perëndimit për Kosovën. Autorësia dhe autenticiteti i dokumentit nuk janë sqaruar publikisht. Bashkësia Islame e Kosovës i ka mohuar pretendimet që përmban ai dhe ka kërkuar hetimin e origjinës dhe vërtetësisë së tij. Publikimi i përmbajtjes së dokumentit nxiti reagime dhe

përplasje në rrjetet sociale, përfshirë pretendime për lidhje mes BIA-s dhe pjesëtarëve të komunitetit mysliman në Kosovë. Por, aktakuzat nuk tregojnë se çfarë ndodh më pas me informacionet që, sipas Prokurorisë, mblidhen dhe i përcillen inteligjencës serbe. Ekspertët e inteligjencës thonë se vetë mbledhja e informacionit është vetëm një pjesë e punës së një shërbimi. Po aq rëndësi ka se kush e siguron atë, çfarë qasjeje ka burimi dhe për çfarë mund të përdoren më pas informacioni dhe rrjeti i krijuar. Daniel Lomas, profesor i inteligjencës dhe sigurisë në Universitetin e Nottinghamit në Angli, thotë se faza e parë zakonisht është mbledhja e informacionit. "Fillimisht përpiqesh të marrësh informacion nga burimet, pra për politikën e një vendi, ekonominë e një vendi, kush është lart, kush është poshtë, thashetheme politike, duke zhvilluar rrjete njerëzish në gjithë shoqërinë", shpjegon Lomas për Radion Evropa e Lirë. Por, sipas tij, rrjetet e krijuara mund të ftojnë më vonë një

funkcion tjetër: të përdoren për ndikim politik.

Çfarë është BIA?

Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit, BIA, është shërbimi civil kombëtar i sigurisë i Serbisë dhe funksionon si organizatë e posaçme e Qeverisë serbe. Ajo u krijua me ligj në vitin 2002, pas ndarjes së shërbimit civil të sigurisë dhe inteligjencës nga Ministria e Brendshme. Sipas ligjit serb, detyrat e BIA-s përfshijnë mbrojtjen e sigurisë së Serbisë, zbulimin dhe parandalimin e veprimtarive që synojnë cenimin e rendit kushtetues, si dhe hulumtimin, mbledhjen, përpunimin dhe vlerësimin e të dhënave të inteligjencës me rëndësi për sigurinë e vendit. Ligji parashikon gjithashtu se BIA mund të bashkëpunojë me shërbime të shteteve të tjera dhe organizata ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Qeverisë dhe politikën e sigurisë dhe inteligjencës së Serbisë. Radio Evropa e Lirë i është drejtuar BIA-s për të marrë qëndrimin e saj lidhur me rastet dhe pretendimet për veprimtarinë e saj në Kosovë, por nuk ka marrë përgjigje.

Çfarë informacioni kërkohe?

Aktakuzat e ngritura në Kosovë japin disa të dhëna për llojin e informacioneve që dyshohet se janë kërkuar.

Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi akuzohen se kanë mbledhur dhe përcjellë informacione që lidheshin me UÇK-në, Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Sipas aktakuzës, Shabani kishte mbledhur edhe materiale për masakrën e Reçakut, ndërsa Qerimi informacione për dëshmitarë të Gjykatës Speciale. Të dy janë deklaruar të pafajshëm dhe procesi gjyqësor ndaj tyre vazhdon. Në një rast tjetër, Fehim Sali dyshohet se gjatë viteve 2024 dhe 2025 ka mbledhur dhe përcjellë informacione dhe dokumente për persona të caktuar në Kosovë, përfshirë persona që Prokuroria i përshkruan si pjesëtarë të qarqeve vebabiste. Në mesin e personave tashmë të dënuar për spiunazh janë Aleksandar Vllajiq dhe Jellena Gjukanoviq. Janjiq thotë se interesi i një shërbimi inteligjent nuk kufizohet vetëm te dokumentet apo të dhënat konkrete. Po aq të rëndësishëm janë njerëzit që kanë qasje në to. Sipas tij, BIA interesohet për burime që mund të sigurojnë informacione, por edhe për persona me ndikim. "Dihet kush është popullata shumicë në Kosovë - janë shqiptarët - dihet kush ka ndikim në ekonomi", thotë Janjiq. Ai shton se synimi është të arrihet te "burime cilësore të informacionit". Por, rëndësia e një burimi brenda një institucioni nuk kufizohet

PROKURORIA: SHEHOLLI KA ZBATUAR NJË PLAN KONKRET QË SYNONTE DËMTIMIN E INTERESAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Fatmir Sheholli është deklaruar i pafajshëm në seancën fillestare të gjyqit ndaj tij si i dyshuar për spiunazh në dëm të Kosovës dhe për shantazh. “E ndiej veten të pafajshëm”, është deklaruar Sheholli në mëngjesin e 7 shtatorit para Gjykatës Themelore në Prishtinë, në lidhje me të dy veprat penale. Sheholli akuzohet se ka bashkëpunuar me Agjencinë e

Sigurisë dhe Informacionit të Serbisë (BIA) dhe se e ka shantazhuar një person për një shumë prej 13 000 eurosh. “I pandehuri ka zbatuar në tërësi edhe një plan konkret i cili synonte dëmtimin e interesave të Republikës e Kosovës dhe ndërhyrjes së procesit zgjedhor të mbajtur më 12.10. 2025”, ka thënë prokurori special në këtë rast, Bekim Kodraliu. Avokati i Sheholli, Mentor Neziri, tha se i pandehuri është

pajtuar që në këtë fazë të mos procedojnë me kërkesën për hedhje të aktakuzës, për faktin se Sheholli ndodhet në paraburgim dhe ka shumë prova personale që do të administrohen. “Gjykatës i propozojmë ta aprovojë propozimin tonë dhe të fillojmë menjëherë me shqyrtim gjyqësor posa gjykata ta ketë mundësinë ta caktojë seancën”, tha avokati. Gjykatësi i rastit, Avni Sylja, e

mbylli seancën e të hënës duke thënë se sapo të caktohet trupi gjyqësor për këtë rast, do të njoftohen palët për caktimin e seancës së radhës. Në aktakuzën prej 80 faqesh, Prokuroria pretendon se Sheholli ka qenë i rekrutuar nga BIA nga një datë e pacaktuar deri më 9 tetor 2025 dhe i ka raportuar Bojan Dimiqit, drejtor i Drejtorisë Kundër Terrorizmit dhe Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

Sheholli akuzohet se ka mbledhur, siguruar dhe i ka përcjellë përmes mesazheve telefonike të dhëna këtij agjenti të BIA-s informacione dhe dokumente që lidhen me aktivitete politike, gjendjen e sigurisë dhe funksionimin e institucioneve të Kosovës. Sheholli u arrestua në tetor të vitit 2025 nën dyshimin për spiunazh. Ai vazhdon të mbahet në paraburgim.



domosdoshmërisht tek ajo që mund të nxjerrë prej tij. Lomas merr si shembull policinë. “Policia mund të bëjë më shumë sesa mund të bëjë qytetari i zakonshëm. Ajo ka kompetenca të ndryshme të mbikëqyrjes. Mund të ketë qasje në lloje të caktuara informacioni”, thotë ai. Një person brenda policisë, sipas tij, mund të ndihmojë edhe në identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë objektiv rekrutimi apo të krijojë mundësi për operacione të tjera.

Çfarë ndodh me informacionin?

Janjiq është i kujdesshëm kur pyetet se çfarë ndodh konkretisht me informacionet që arrijnë te BIA. “Këtë, sinqerisht t’ju them, vetëm mund ta imagjinoj”, thotë ai. Në parim, sipas tij, informacionet kalojnë në sektorët analitikë, ku “renditen, klasifikohen” dhe më pas përdoren në varësi të vlerësimit, para së gjithash, politik. Ai përmend shantazhin dhe ndikimin si disa nga mundësitë e përdorimit të tyre. Lomas e shpjegon procesin nga perspektiva e funksionimit të shërbimeve të inteligjencës në përgjithësi. Informacioni për politikën, institucionet dhe individët, thotë ai, mund t’i tregojë një shërbimi të huaj se ku ndodhen dobësitë apo përçarjet brenda një qeverie,

partie ose shoqërie. “Inteligjenca të lejon të hapësh çarje brenda qeverive, partive politike, shoqërisë më të gjerë, sepse të jep njohuri të qarta se si ta shfrytëzosh një shoqëri të caktuar”, thotë Lomas. Hapi tjetër, sipas tij, mund të jetë ajo që në botën e inteligjencës njihet si “veprim i fshehtë”: jo më vetëm mbledhje e informacionit, por ndërmarrje veprimesh mbi bazën e asaj që është mësuar. “...pra, nuk je më vetëm duke qëndruar mënjane dhe duke mbledhur informacione, por edhe bën diçka duke u bazuar në to”, thotë ai. Kjo nuk do të thotë se rastet e zbuluara në Kosovë dëshmojnë ekzistencën e një strategjie të tillë të koordinuar të BIA-s. Proceset gjyqësore kanë të bëjnë me përgjegjësinë individuale të personave konkretë, ndërsa një pjesë e pretendimeve të Prokurorisë ende nuk janë provuar me aktgjykime përfundimtare. Radio Evropa e Lirë pyeti Prokurorinë Speciale të Kosovës për numrin e personave nën hetim, aktakuza apo gjykim për spiunazh në favor të Serbisë, për lidhjet dhe metodat e mundshme të përbashkëta mes rasteve, si dhe për dyshimet për përfshirjen e personave brenda institucioneve publike, por nuk mori përgjigje. Përgjigje nuk dha as Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, të cilën REL-i e pyeti për vlerësimin e saj mbi shtrirjen e mundshme të veprimtarisë së BIA-s dhe

rrezikun që ajo mund të paraqesë për institucionet e Kosovës.

A mund ta destabilizojë një vend spiunazhi?

Lomas paralajmëron kundër përfundimit se spiunazhi, vetvetiu, mund të destabilizojë një shtet. “Mendoj se spiunazhi të çon vetëm deri në një pikë”, thotë ai. Shërbimet e huaja, sipas tij, nuk kanë nevojë t’i krijojnë vetë ndarjet apo pakënaqësitë brenda një shoqërie. Ato mund t’i identifikojnë dhe t’i shfrytëzojnë ato. Për ta shpjeguar këtë mekanizëm, Lomas merr Rusinë si shembull. Ai përmend debatet rreth migracionit në Gjermani, duke theksuar se shqetësimet e një pjese të shoqërisë për këtë çështje nuk janë krijuar nga Rusia. Por, sipas tij, aktorë të jashtëm rusë i kanë amplifikuar pakënaqësitë e tilla, përfshirë përmes rrjeteve sociale. Ai e krahason këtë edhe me një zjarr: pakënaqësitë ekzistojnë, ndërsa ndërhyrja nga jashtë mund t’i shtojë “karburant zjarrit”, duke i bërë më të mëdha dhe më të rrezikshme. Lomas nuk thotë se rastet në Kosovë dëshmojnë një model identik. Por, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ai e sheh këtë edhe në kontekstin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës dhe përplasjes së saj më të gjerë me Perëndimin. Sipas tij, Rusia mund të ketë interes në hapësira ku tensionet

ekzistuese mund të mbahen të hapura dhe ku vëmendja e NATO-s mund të zhvendoset drejt një krize tjetër. Në Kosovë, debati që shkaktoi dokumenti “Top sekret 2”, autorësia dhe autenticiteti i të cilit mbeten të pasqaruara, tregoi se sa shpejt një çështje e ndjeshme mund të prodhojë polarizim. Për Janjiqin, rrjedhja e informacionit, infiltrimi në institucione dhe përpjekjet për ndikim nuk mund të shihen krejtësisht të ndara. Ai e lidh veprimtarinë e inteligjencës edhe me politikën e Serbisë për të mos e njohur Kosovën dhe me interesin për informacione që, sipas tij, mund të përdoren për diskreditimin e saj. “Kur nuk e njeh Kosovën, atëherë duhet të mbledhësh sa më shumë të dhëna negative për gjendjen atje”, thotë Janjiq.

Si mund të mbrohet Kosova?

Për Lomasin, mbrojtja nuk fillon vetëm me zbulimin dhe arrestimin e personave të dyshuar. Një prej mjeteve është edhe ekspozimi publik i mënyrave se si veprojnë shërbimet e huaja të inteligjencës. Ai përmend përvojën e vendeve të Evropës Perëndimore, ku publikimi i rasteve të spiunazhit është përdorur edhe për të tritur ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve për mënyrat e

rekrutimit dhe rreziqet që sjellin ato. “Fakti që i keni pasur këto arrestime dhe se ato janë bërë publike është një mënyrë për t’ua bërë të qartë njerëzve se këto shërbime të huaja të inteligjencës paraqesin kërcënim. Ato janë rrezik. Nuk do të zhduken”, thotë Lomas. Po aq i rëndësishëm, sipas tij, është kundërzbulimi: identifikimi i njerëzve dhe institucioneve që mund të jenë më të cenueshëm, zbulimi i përpjekjeve për rekrutim dhe shkëmbimi i informacionit me partnerët ndërkombëtarë. Edhe Janjiq e vë theksin te forcimi i kapaciteteve të inteligjencës dhe sigurisë në Kosovë. Por, ai thotë se përgjegjësia nuk bie vetëm mbi institucionet kosovare. Sipas tij, NATO-ja, Shtetet e Bashkuara dhe partnerët evropianë kanë rol në ngritjen e standardeve të sigurisë, forcimin e kapaciteteve të institucioneve kosovare dhe krijimin e mekanizmave më të mirë të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit. Rastet e zbuluara deri tani, megjithatë, nuk japin përgjigje për përmasën e mundshme të veprimtarisë së BIA-s në Kosovë. Nuk dihet publikisht se sa persona mund të jenë rekrutuar, sa gjatë mund të kenë zgjatur lidhjet me inteligjencën serbe apo sa informacione mund të kenë përfunduar tek ajo. Për një pjesë të të akuzuarve, edhe vetë pretendimet e Prokurorisë duhet ende të provohen në gjykatë

“LIRI PËR DEPUTETËT E VV-së!”, ALEANCA ZHVILLON AKSION PARA KUVENDIT

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Aleanca ka zhvilluar të hënën një aksion simbolik para objektit të Kuvendit të Kosovës, përmes të cilit ka kritikuar mënyrën e funksionimit të brendshëm të Lëvizjes Vetëvendosje dhe ka ngritur pretendime për mungesë të demokracisë brenda grupit parlamentar të kësaj partie. Në kuadër të aksionit Aleanca ka shtruar pyetjen nëse deputetët e Vetëvendosjes kanë mundësi t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre. “Regjim në parti, regjim në

shtet! A keni dëgjuar ndonjëherë deputetët e LV-së të flasin mendimin e tyre? Jo”, thuhet në reagimin e Aleancës. Sipas saj, deputetët e LV-së nuk kanë liri të mjaftueshme për t'i shprehur qëndrimet e tyre, ndërsa vendimmarrja brenda partisë karakterizohet, sipas Aleancës, nga një “grusht i hekurt”. Aleanca ka shprehur shqetësimin se një model i tillë i funksionimit partiak po tentohet të zbatohet edhe në institucionet e Kosovës. “Problemi u zgjerua kur ai model po tentohet të zbatohet në shtet, në institucionet e

Kosovës”, thuhet në reagim. Aleanca ka pretenduar se deputetët e Vetëvendosjes, në rrethana jopublike, kanë shprehur shqetësime se janë të kufizuar në ushtrimin e mandatit të tyre parlamentar. “Pra, nuk kanë liri”, ka deklaruar Aleanca, duke kërkuar që kjo çështje të diskutohet publikisht. Në fund, Aleanca ka bërë thirrje për më shumë hapësirë për deputetët e Vetëvendosjes që, sipas saj, të mund ta ushtrojnë lirshëm mandatin e marrë nga qytetarët. “Liri për deputetët e VV-së!”, ka përfunduar aksioni i Aleancës.



95 PËR QIND E PROBLEMEVE ME TË CILAT PËRBALLEN AKTUALISHT KOMUNAT JANË SHKAKTUAR NGA QEVERTITË

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Përplasja mes pushtetit qendror dhe atij lokal në Kosovë u thellua deri në protestimin para qeverisë nga disa udhëheqës lokalë të cilët e akuzojnë ekzekutivin për cenim të kompetencave dhe probleme me financimin. Kryetarë të disa komunave të Kosovës, ku udhëheqin Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca, pretendojnë se po vonohen e po bllokohen fondet për projekte komunale dhe se komunat po përballen me barrë të madhe financiare nga obligimet e kontratave kolektive. Bekim Salihu, analist politikash në Institutin GAP, në Prishtinë, thotë në podkastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë se komunat e Kosovës përballen me probleme reale të cilat rrezikojnë një falimentim funksional të tyre. Ai vlerëson se pjesa më e madhe e problemeve financiare të komunave nuk kanë nisur gjatë qeverisjes së Kosovës nga Albin Kurti, por janë trashëguar nga qeveritë e mëparshme të vendit. “Nëntëdhjetë e pesë për qind e problemeve me të cilat përballen komunat aktualisht janë probleme që janë shkaktuar nga qeveritë,



jodomosdoshmërisht nga kjo qeveri”, thotë Salihu. Megjithatë, sipas tij, qeveria Kurti mban përgjegjësi për faktin se nuk i ka adresuar këto probleme. “Qeveria Kurti bëhet përgjegjëse për shkak të një lloj mosinteresi, neglizhimi, injorimi të nevojave dhe shqetësimeve që i kanë komunat”, shprehet ai.

Mbi 300 milionë euro obligime nga kontratat kolektive

Një nga problemet kryesore që rëndon mbi komunat, sipas Salihut, janë obligimet që rrjedhin nga kontratat kolektive në arsim dhe shëndetësi.

Kontratat kolektive janë marrëveshje midis punëdhënësit dhe sindikatave të punëtorëve, ku përcaktohen kushte dhe të drejta të punës, të cilat zakonisht përfshijnë pagesa për udhëtime, shujta, trajnime profesionale, paga jubilarë për punëtorët dhe përfitime të tjera. Salihu thotë në 5 pyetje se këto kontrata janë lidhur nga niveli qendror, ndërsa obligimet financiare kanë përfunduar te komunat, të cilat menaxhojnë me arsimin parauniversitar dhe kujdesin parësor shëndetësor. “Mbi 300 milionë euro kanë paguar obligime, jo vetëm nga kontratat kolektive. Edhe nga vendimet dhe ligjet e tjera që i ka nxjerrë niveli qendror”, tregon ai.

Edhe pse komunat e udhëhequra nga Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë Kurti nuk e mbështetën protestën e fundit, Salihu thotë se problemet financiare dhe funksionale janë të njëjta në të gjitha komunat. “Nuk është që me këto probleme po përballen vetëm komunat që udhëhiqen nga LDK-ja, ose vetëm komunat që udhëhiqen nga PDK-ja, por po përballen të gjitha”, thekson ai.

Rrezikimi i investimeve kapitale

Përplasja financiare mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta edhe për qytetarët, pasi mjetet

që tërhiqen për shlyerjen e obligimeve gjyqësore mund të merren nga projektet komunale. Salihu jep shembullin e buxhetit vjetor të një komune, ku nuk përfshihen obligimet financiare nga kontratat kolektive dhe më vonë paratë për këtë merren nga kategori të tjera të buxhetit. “Të gjitha paratë që janë marrë nga gjykata, përmbaruesi, për të shlyer obligime financiare që rrjedhin nga kontratat kolektive, janë marrë nga projektet komunale”, thotë ai. Madje, sipas tij, ka raste kur Thesari i shtetit ndërhyr për të marrë këto mjete nga projekte kapitale që janë në proces e sipër. Ai shton se komunat mund të vazhdojnë të ofrojnë shërbime esenciale, por mund ta kenë gjithnjë e më të vështirë realizimin e projekteve kapitale. Sipas Salihut, zgjidhja e problemit mes komunave dhe ekzekutivit nuk është e pamundur, por kërkon vullnet politik. “Ka mosbesim, ka mungesë, ka moskomunikim”, thotë ai në pesë pyetje, duke shtuar se në disa raste qeveria, sipas tij, ka tentuar “t'i ngacmojë” komunat përmes ndryshimeve ligjore që prekin të hyrat vetjake dhe pronën komunale.

Policia e Kosovës shënon 27-vjetorin e themelimit

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Më 6 shtator 2026 u mbajt ceremonia solemne me rastin e 27-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës. Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, ndërsa pjesëmarrjen e nderuan edhe personalitete të larta shtetërore, përfshirë ushtruesen e detyrës së Presidentes, Albulena Haxhiu, kryeministrin e Republikës së

Kosovës, Albin Kurti, si dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Me këtë rast, përfaqësuesit institucionalë iu drejtuan të pranishmëve me fjalë rasti, duke uruar Policinë e Kosovës për 27-vjetorin e themelimit dhe duke vlerësuar punën e saj ndër vite. Në adresimet e tyre u theksua se, gjatë këtyre 27 viteve, Policia e Kosovës është ndërtuar si një organizatë moderne dhe

profesionale, e përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi. Po ashtu, u vlerësua kontributi i pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në ruajtjen e rendit dhe sigurisë, duke theksuar se falë punës së tyre të vazhdueshme dhe profesionalizmit të lartë, Policia e Kosovës vazhdon të jetë një nga institucionet më të besueshme dhe transparente



në vend. Ceremonia shërbeu edhe si një moment për ta nderuar punën,

përkushtimin dhe kontributin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës ndër vite.

Shahini takon në Paris senatorët Meignen dhe Szpiner

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, gjatë qëndrimit në Paris ka zhvilluar një takim me senatorët francezë Thierry Meignen dhe Francis Szpiner, me të cilët ka diskutuar për forcimin e marrëdhënieve Kosovë - Francë dhe hapjen e mundësive të reja për bashkëpunim ekonomik. Takimet ishin në frymën e rritjes së besimit dhe investimeve franceze në Kosovë, forcimi i

bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të të dyja vendeve, promovimi i potencialeve ekonomike të Kosovës dhe krijimi i partneriteteve të reja me kompanitë franceze. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, vlerësoi se Franca është një partner strategjik dhe i rëndësishëm evropian për Kosovën, ndërsa theksoi se marrëdhëniet politike duhet të shoqërohen me bashkëpunim konkret ekonomik dhe investime të qëndrueshme.

“Kosova ka nevojë për më shumë miq, por mbi të gjitha për partneritete konkrete. Investimet franceze në Kosovë do të ishin një sinjal i fuqishëm i besimit në ekonominë dhe të ardhmen e vendit tonë. Ne duhet të krijojmë ura të reja mes bizneseve kosovare dhe atyre franceze”, ka thënë Shahini, duke shtuar se AKB-ja do ta vazhdojë angazhimin për ndërkombëtarizimin e bizneseve të Kosovës, tërheqjen e investimeve të huaja dhe



promovimin e Kosovës si destinacion për investime dhe partneritete në Ballkanin Perëndimor dhe EU-së.

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE FUQIZOJNË KOMUNIKIMIN DIGJITAL PËR SËMUNDJET KRONIKE JONGJITËSE

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Përfaqësuesit e institucioneve të shëndetit publik në Kosovë fuqizuan kapacitetet e tyre për ta shndërruar evidencën shkencore në përmbajtje digjitale të qartë, tërheqëse dhe që nxit veprim, gjatë një trajnimit praktik dyditor të mbajtur më 3-4 shtator 2026. Trajnimi mbledhi ekspertë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), si dhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe

Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Pjesëmarrësit punuan me prioritet konkret të shëndetit publik për të zhvilluar mesazhe të përshtatura për audiencën, përmbajtje për rrjetet sociale, infografika dhe fushata të koordinuara digjitale. “Informacioni i saktë shëndetësor krijon vlerë më të madhe për publikun kur njerëzit mund ta kuptojnë më mirë dhe nxitin të veprojnë. Trajnimet e këtij lloji i



ndihmojnë institucionet e shëndetit publik ta ndërthurin besueshmërinë shkencore me një komunikim të qartë, të qasshëm dhe me ndikim”, tha

prof. dr. Merita Berisha nga IKShPK-ja. Përmes ushtrimeve praktike, pjesëmarrësit shndërruan informacionin teknik mbi sëmundjet jongjitëse në mesazhe shëndetësore dhe zhvilluan koncepte komunikimi për Ditën Botërore të Zemrës, Ditën Botërore të Diabetit, Ditën Botërore të Kancerit, Ditën Botërore të Shëndetit dhe Ditën Botërore pa Duhan. Gjatë trajnimit u paraqitën gjithashtu formate të

ripërdorshme të infografikave dhe një kalendar i strukturuar për komunikimin digjital shëndetësor gjatë gjithë vitit. Nisma kontribuon në fuqizimin e komunikimit institucional, i cili mbështet parandalimin, nxit sjellje më të shëndetshme dhe e sjell informacionin e besueshëm shëndetësor më pranë qytetarëve. Trajnimi u mbështet nga Projekti Shërbimet Shëndetësore të Integruara (IHS).

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E PARTICIPIMIT PËR PJESËMARRJEN E FSK-së NË KUADËR TË FORCËS NDËRKOMBËTARE STABILIZUESE GAZA

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Në kuadër të vizitës zyrtare në Kosovë të komandantit të Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese (International Stabilization Force - ISF) Gaza, gjeneralmajor Jasper Jeffers dhe stafit të tij, në praninë e ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe përfaqësuesit të Bordit të Paqes, u nënshkrua marrëveshja e participimit ndërmjet përfaqësuesve të BoP/ISF Gaza dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, për pjesëmarrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës në kuadër të këtij misioni. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, GJM Jeffers, në cilësinë e komandantit të ISF Gaza, vlerësoi lart vendimin dhe gatishmërinë e Kosovës për të kontribuar në këtë mision



ndërkombëtar, duke theksuar rëndësinë e kontributit të FSK-së në përpjekjet për paqe, siguri dhe stabilitet. Gjeneralmajor Jeffers shprehu

mirënjohjen për udhëheqjen e Kosovës dhe përkushtimin e treguar, duke vlerësuar angazhimin dhe leadershipin e institucioneve të Kosovës në

mbështetje të këtij misioni. Nga ana e tij, GLT Jashari falënderoi GJM Jeffers për vlerësimin dhe bashkëpunimin, duke theksuar se pjesëmarrja e

FSK-së në misionet ndërkombëtare të sigurisë është pjesë e vizionit të Kosovës për të dhënë kontribut konkret në promovimin e paqes dhe sigurisë në botë. KOMFSK theksoi se FSK synon ta rrisë vazhdimisht kontributin në sigurinë ndërkombëtare, me një objektiv të qartë strategjik: kalimin nga një importues i sigurisë në një eksportues të saj. Duke kontribuar në mënyrë aktive në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë, së bashku me aleatët dhe partnerët ndërkombëtarë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e rolit të Kosovës si kontribuuese aktive në përpjekjet ndërkombëtare për paqe, siguri dhe stabilitet.

Rahoveci shkëlqeu në “Hardh Fest 2026”

RAHOVEC, 7 SHTATOR - Është përmbyllur me sukses edicioni i sivjetmë i Festës së Vjeljes së Rrushit - “Hardh Fest 2026”, duke e kthyer Rahovecin edhe këtë vit në një nga qendrat kryesore të kulturës, turizmit dhe traditës së verarisë në Kosovë.

Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, e ka vlerësuar të jashtëzakonshëm edicionin e këtij viti, duke falënderuar organizatorët, në krye me Agron Sokolin, si dhe policinë, zjarrfikësit, QKMF-në, sigurimin, donatorët, mediet dhe të gjithë

kontribuuesit. “Si komunë do të vazhdojmë ta mbështesim dhe ta fuqizojmë ‘Hardh Fest’-in, sepse ky festival është krenari për Rahovecin dhe një mundësi e jashtëzakonshme për të promovuar vreshtarinë, verën, kulturën dhe

mikpritjen tonë”, ka shkruar Latifi në “Facebook”. Në fund kryetari i Rahovecit ka bërë me dije se mbështetja për festivalin do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke i ftuar të gjithë në edicionin e ardhshëm: “Ju mirëpresim në ‘Hardh Fest’ 2027!”.



NJË FLETËZ NË 27-VJETORIN E THEMELIMIT TË SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS (SHPK) MË 6 SHTATOR 1999

SHQIPE KRASNIQI DHE SHQIPET E TJERA MERITOJNË MË SHUMË VLERËSIM

**Në një familje me 11 burra u rrit një vajzë.
E vetmja, por jo e brishta**


PRISHTINË, 7 SHTATOR - Historia e vajzave shqiptare është përplot rrëfime të patreguara, të heshtura, në okupim, në luftë a në paqe. Shqipe Krasniqi është një prej tyre: një studente që

“Mustafa Bakija” të Carrallukës), që shkon në luftën çlirimtare në orët e para të saj (prill 1998); një ushtarë e lirisë që bëhet ruajtëse e saj qysh në minutat e para të Policisë së



nuk e lëshon Kosovën kur mbyllet sistemi arsimor, por vazhdon shkollimin në kushtet e mbijetesës së arsimit shqiptar dhe diplomon në Fakultetin Juridik një mësimdhënëse (nga 1 shtatori 1996 në shkollën

Kosovës. Dhe, një ditë, nënë, pavarësisht çdo sfide. Jeta nuk i ka mbaruar ende faqet e vështira. Shtohet një që nuk pritej në atë moshë: shëndeti, që e rrëzoi disa herë, por Shqipja u ngrit një herë më




shumë se aq! Me nëntë shpirtra e quanin shokët kur ia hodhi sfidës shëndetësore edhe kur dukej gati e pamundur.

Nuk ka çfarë të fitojë më shumë një triumfuese e shumëfishtë sesa mbi kaq sprova. Të tjerët mund ta nderojnë qetësisht a ta

ngrenë në qiell, mund të heshtin ose të bëhen se nuk e njohin, por për karakterin stoik këto nuk ndryshojnë asgjë: ajo





mbetet po ajo, brenda kodit që e trashëgoi nga i ati - një mësues i dëshmuar, patriot e frymëzues brezash: Jashar Sherif Krasniqi nga Tërpeza e Ulët e Malishevës. Edhe Shqipja ishte bërë frymëzim sidomos për vajzat e tjera, pse jo motivim edhe për ushtarët e tjerë që të mos hamendeshin për asnjë çast për idealin e lirisë. Një herë, në njërin prej misioneve ushtarake, Shqipja me shokë u sfidua me 72 orë rrugëtim të rrezikshëm për në Shqipëri, për furnizim me armë në kushte ekstreme, për t'u kthyer përsëri në front. Por, përpara ishte fatura edhe më e rëndë e rrugës së çlirimit kombëtar, që ende

Dorëzim e kthim prapa s'ka nga kjo rrugë, as ligështim pas lirisë. Nga luftëtarja në radhët e para të Ushtrisë Çlirimtare, Shqipja është edhe në orët e para në themelet e ndërtimit të Policisë së Kosovës. 6 shtatori 1999 është dita e themelimit të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK). Në Shkollën e Policisë në Vushtrri filloi



trajnimi i gjeneratës së parë me 176 kadetë. Më 16 tetor 1999 gjenerata e parë përfundoi trajnimin në klasë dhe u sistemua në stacione policore, duke filluar shërbimin në terren nën mbikëqyrjen e policisë ndërkombëtare. Shqipja filloi detyrën në Prizrenin historik.

pamundurën, bashkë me kolegët e saj, që nderimet të shkonin në vendin e duhur: te komandanti legjendar. Dhe kjo hyn në histori si paraqitja e parë e Policisë së Kosovës me uniformë në Prekaz, edhe pse nga 173 të diplomuar vetëm 81 policë të rinj shkuan, - një dallim jozyrtar ky ndërmjet këtyre ish-pjesëtarëve të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kryesisht ish-pjesëtarëve të policisë krahinore të kohës jugosllave dhe ndonjë minoritari. Natyrisht se nuk do të bënte jehonë të mirë në strukturat unmikase fjalimi i Shqipe Krasniqit në Prekaz dhe, ironikisht, është e



përgjegjësi dhe zbatim të ligjit. Rruga e gradimeve të larta do të ishte tjetra, më e shkurtër, siç e dimë. Megjithatë, përkushtimi gjatë këtyre 27 viteve në shërbim policor është vlerësuar me 8

ndaj shërbimit dhe shtetit të Republikës së Kosovës. Shqipja i ka përfunduar të gjitha trajnimet e nevojshme brenda Policisë së Kosovës dhe në institucione të tjera të vendit dhe, thjesht, ende mban vetëm titullin Oficer e Policisë së Kosovës.

Dhe asaj nuk i pëlqen ta pyesësh se pse një grua me 27 vjet shërbim, me dhjetëra trajnime, tetë mirënjohje, një lavdatë dhe dy medalje, e cila për vite me radhë është dëshmuar si shembull i profesionalizmit, respektimit të ligjit dhe përgjegjësisë shtetërore, nuk është vlerësuar me gradën që meriton. Në fakt, ajo nuk është adresa për këtë pyetje. Janë të tjerët, jemi të gjithë ne që do të duhej të gjenim a t'i jepnim një shpjegim Shqipes dhe shqipeve të tjera të Kosovës, jo vetëm në këtë shërbim, por edhe në drejtime të tjera të sigurisë. Këto shqipe nuk kërkuar rrugë të lehta në kohë të vështira, ndaj nuk kërkojnë grada të rënda në kohë të lehta - nëse jemi në kohë të tilla, me çfarë po ngjan e çfarë mund të ngjajë. (Muhamet MAVRA)




nuk kishte ardhur: ajo përjetoi masakrimin e babait, rënien e shumë bashkëluftëtarëve dhe ishte dëshmitare e vrasjeve, djegieve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare nga Kosova.

Askush tjetër në Kosovë, para Prekazit të Adem Jasharit, nuk meritonte më shumë që t'i bënte nderime uniforma e policisë së lirisë. Shqipja, në kontekstin e asaj kohe të UNMIK-ut, bëri të



vetëkuptueshme që gjatë periudhës së UNMIK-ut nuk mori grada. Shqipja dhe disa kolegë dinjitozë kishin qëndrim të qartë: jo lojalitet ndaj individëve apo strukturave politike, por profesionalizëm,

mirënjohje për punë profesionale dhe përgjegjësi të lartë në zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë; 1 lavdatë për punë të dalluar dhe për të qenë shembull për të tjerët; 2 medalje për besnikëri



EKSPERTJA E OKB-së FRANCESCA ALBANESE KËRKON “NDRYSHIM TË VËRTETË PARADIGME”, NDËRSA BRITANIA RISHIKON POLITIKËN NDAJ IZRAELIT

Planet e Britanisë së Madhe për të ndaluar tregtinë me vendbanimet e paligjshme izraelite janë një hap i rëndësishëm, por nuk mjaftojnë nëse Londra synon një ndryshim real të politikës ndaj Izraelit dhe Palestinës. Kështu është shprehur Francesca Albanese, raportuesja speciale e OKB-së për territoret palestineze të pushtuara, në një intervistë për The Guardian, publikuar më 7 shtator.

Ministri i Jashtëm britanik, Ed Miliband, ka paralajmëruar masa më të forta ndaj vendbanimeve izraelite dhe kufizimeve të vazhdueshme të ndihmave që hyjnë në Gaza. Paketa e re e politikës britanike pritet të shpallet të martën dhe grupet palestineze në Britani po presin detajet përpara se të japin një vlerësim përfundimtar.

Albanese e cilësoi ndalimin e mallrave nga vendbanimet izraelite si një ndryshim “absolutisht të rëndësishëm” të qëndrimit të qeverisë britanike dhe tha se nuk dëshiron ta hedhë poshtë si një veprim thjesht teatral përpara se të bëhen publike masat konkrete. Por, sipas saj, ndalimi duhet të jetë pjesë e një “ndryshimi të vërtetë paradigme” në marrëdhënien me Izraelin dhe Palestinën. Me këtë, Albanese kërkon jo thjesht një masë të izoluar, por ndryshim të të gjithë mënyrës se si Britania e trajton pushtimin izraelit.

Ajo iu referua opinionit këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të vitit 2024, sipas të cilit prania e Izraelit në territoret e

pushtuara është e paligjshme. Albanese argumenton se shtetet e tjera kanë detyrimin të mos e njohin këtë situatë si të ligjshme dhe të mos ofrojnë ndihmë apo asistencë për vazhdimin e saj.

Pikërisht për këtë arsye, sipas saj, ndalimi nuk duhet të kufizohet vetëm te produkte si ushqimet bujqësore apo kozmetika që vijnë nga vendbanimet. Ajo kërkon që Londra të shqyrtojë edhe tregtinë e shërbimeve, bashkëpunimin britanik të inteligjencës, licencat për armët dhe fluturimet nga baza britanike RAF Akrotiri në Qipro. Albanese paralajmëroi se, nëse masa të tilla përjashtohen, ndryshimi i politikës britanike mund të përfundojë duke u parë jo si një përballje reale me problemin, por thjesht si një “njoftim për shtyp”.

Për ta ilustruar argumentin, ajo mori si shembull vendbanimin Ma’ale Adumim në Bregun Perëndimor. Sipas saj, një shtet nuk mund të ndalojë hurmat që vijnë nga ky vendbanim dhe, në të njëjtën kohë, të vazhdojë të licencojë pajisjet që përdoren për funksionimin e sistemit të kontrollit rreth tij. Në një rast të tillë, tha Albanese, nuk është ndryshuar marrëdhënia me pushtimin, por vetëm mënyra e komunikimit të saj.

Një tjetër pikë shqetësimi është projekti E1, i cili parashikon zgjerimin e vendbanimeve në Bregun Perëndimor dhe që kritikët paralajmërojnë se do të ndajë Jerusalemin Lindor nga pjesa tjetër e Bregut Perëndimor. Ministri izraelit i Financave, Bezalel Smotrich, ka



deklaruar se projekti synon të “varrosë idenë e një shteti palestinez”.

Albanese kërkon që Britania të mos mjaftohet me kundërshtime politike ndaj projektit. Sipas saj, ndërtimi në një shkallë të tillë kërkon financim, sigurime dhe kompani ndërtimi, ndaj duhet të shqyrtohen sanksione ndaj kompanive që do të bashkëpunojnë në realizimin e E1.

Deklaratat e Albanese vijnë ndërsa ndryshimi i kursit britanik ka shkaktuar një përplasje të fortë diplomatike.

Ambasadori amerikan në Izrael, Mike Huckabee, e akuzoi qeverinë britanike për “urrejtje ndaj hebrenjve”, pasi Miliband paralajmëroi politikën e re. Ministria e Jashtëme izraelite gjithashtu kundërshtoi pretendimet britanike për kufizimin e ilaçeve që hyjnë në Gaza.

Albanese kërkoj gjithashtu që Britania të mbështesë më aktivisht mekanizmat ndërkombëtarë të përgjegjësisë ligjore, përfshirë proceset në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Mesazhi i saj për qeverinë

britanike është, në thelb, se ndalimi i disa produkteve nga vendbanimet mund të jetë fillimi, por jo “ndryshimi i paradigmes” që ajo kërkon.

Nëse Londra dëshiron të ndryshojë realisht politikën ndaj pushtimit, argumenton Albanese, ndryshimi duhet të prejë jo vetëm mallrat që vijnë prej vendbanimeve, por edhe marrëdhëniet ekonomike, ushtarake dhe institucionale që mund të ndihmojnë në mbajtjen e sistemit ekzistues.

Burimi: The Guardian, 7 shtator 2026.

ZBULOHET MISIONI SEKRET AMERIKAN PËR PASTRIMIN E HORMUZIT

Forcat speciale amerikane kaluan katër muaj duke kryer një mision sekret pastrimi nga minat në Ngushticën e Hormuzit në një përpjekje për të hapur rrugën ujore, raportoi Financial Times.

Operacioni i fshehtë u krye mes shkëmbimeve të vazhdueshme të sulmeve midis SHBA-së dhe Iranit përreth Ngushticës. Zhytësit e Navy SEAL punuan me anije pa pilot, robotë dhe pajisje të specializuara nënujore për të gjetur dhe hequr minat e dyshuara iraniane, shpesh duke vepruar natën.

Objektivi i operacionit ishte ta bënte ngushticën më të sigurt për anijet tregtare që kishin

shmangur kryesisht rrugën ujore që kur SHBA-të dhe Izraeli sulmuan Iranin në shkurt. Irani ka thënë se kishte vendosur mina në ujërat ndërkombëtare dhe të Omanit pas shpërthimit të luftës.

Organizata Ndërkombëtare Detare vlerësoi në qershor se afërsisht 80 mina ishin vendosur përgjatë rrugëve të rëndësishme të transportit detar.

Presidenti amerikan Donald Trump, njoftoi javën e kaluar se “të gjitha minat” në ujërat ndërkombëtare të ngushticës ishin hequr ose shkatërruar, një pretendim i konfirmuar më pas nga ushtria amerikane.





SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Zhegrova qëndron te Juventusit

TORINO, 7 SHTATOR - Edon Zhegrova nuk do të largohet nga Juventusit, të paktën deri në afatin kalimtar të dimrit, kanë bërë me dije mediumet italiane. Kësisoj, sulmuesi anësor do ta ketë edhe një mundësi për ta dëshmuar veten te Juventusit

deri në muajin janar të vitit të ardhshëm. Zhegrova ishte pranë largimit nga Juventusit këtë verë, por marrëveshja e mundshme për transferimin e tij në Arabinë Saudite, tek Al-Ittihadi, është mbyllur plotësisht. Futbollisti i Kosovës

duhet ta bindë trajnerin Luciano Spalletti se meriton më shumë minuta te Juventusit këtë sezon, në të cilin ka regjistruar vetëm dy paraqitje në Serinë A. E rëndësishme është se Zhegrova është përfshirë në listën e lojtarëve për të luajtur

në kampionat, pasi është lënë jashtë listës për Ligën e Evropës. Zhegrova i ishte bashkuar Juventusit verën e kaluar nga Lille për 15 milionë euro dhe me klubin italian ka kontratë deri në verën e vitit 2030.



MALISHEVA, LIDERE E SUPERLIGËS NË FUTBOLL

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Malisheva ka marrë një fitore të rëndësishme ndaj Gjilanit, ndërsa Ballkani ka vazhduar serinë e rezultateve pozitive në xhiron e katërt të Albi Mall Superligës së Kosovës. Fitore ka regjistruar edhe Dukagjini ndaj Llapit, ndërsa kampionia në fuqi, Drita, është ndalur në barazim pa gola nga Drenica. Malisheva ka mposhtur Gjilanin me rezultat 3:1, në një ndeshje ku protagonistin kryesor ka qenë sulmuesi nga Azerbajxhani, Vusal Isgandarli. Ai ka realizuar të tre golat e skuadrës, duke kompletuar “hat-trickun”. Isgandarli e ka zhblllokuar rezultatin në minutën e 10, ndërsa Gjilani ka reaguar shpejt duke barazuar shifrat në minutën e 19 përmes Oltion Bilallit. Megjithatë, Malisheva ka arritur ta rikthejë epërsinë në pjesën e dytë. Isgandarli ka shënuar fillimisht në minutën e 71-të, ndërsa vetëm katër minuta më vonë, në të 75-n, ka realizuar edhe golin e tretë personal dhe të skuadrës së tij për 3:1. Me këtë fitore Malisheva është ngjitur në krye të tabelës me 10 pikë. Prishtina renditet e dyta me nëntë pikë dhe një ndeshje më pak, ndërsa Ballkani ka nëntë pikë në pozitën e tretë. Gjilani, në anën tjetër, renditet i gjashti me shtatë pikë. Për skuadrën gjilanase kjo ishte humbja e

parë e sezonit, pas dy fitoreve dhe një barazimi. Fitore të rëndësishme ka shënuar edhe Ballkani, që në Suharekë e ka mposhtur Feronikelin '74 me rezultat 2:0. Suharekasit e kanë siguruar fitoren që në pjesën e parë, duke shënuar dy herë brenda gjashtë minutash. Abou Dosso e ka zhblllokuar rezultatin në minutën e 14-t, ndërsa Albert Diene ka realizuar për 2:0 në minutën e 20. Fitorja ndaj Feronikelit '74 ka qenë e treta radhazi për Ballkanin, i cili pas katër xhirove ka grumbulluar nëntë pikë dhe është ngjitur në vendin e tretë të tabelës. Në ndeshjen tjetër të xhiros kampionia në fuqi e Kosovës, Drita, është ndalur në barazim pa gola, 0:0, nga Drenica. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin me bari sintetik në Gjilan ka sjellë raste për të dyja

RENDITJA TABELARE NË SUPERLIGË:	
Malisheva	10
Prishtina	9
Ballkani	9
Dukagjini	8
Drita	7
Gjilani	7
Drenica	3
Vushtrria	0
Feronikeli '74	0
Llapi	0



skuadrat, por as Drita dhe as Drenica nuk kanë arritur t'i konkretizojnë mundësitë e krijuara. Kësisoj, rrjetat kanë mbetur të paprekura deri në vërshtëllimën e fundit. Për Dritën ky ka qenë barazimi i parë në këtë edicion, pas dy fitoreve në tri ndeshjet e zhvilluara deri më tani. Kampionia në fuqi nuk e ka zhvilluar ndeshjen e xhiros së dytë ndaj Prishtinës për shkak të angazhimeve në garat evropiane. Drenica, ndërkaq, ka regjistruar barazimin e tretë në këtë sezon, krahas një humbjeje. Fitore ka shënuar edhe Dukagjini, i cili në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë e ka mposhtur Llapin me rezultat 2:1. Skuadra nga Klina e ka nisur më mirë takimin dhe ka kaluar në epërsi në minutën e 16 përmes Dienit Isufit. Llapi ka arritur të reagojë dhe ta barazojë rezultatin në minutën e 32-të, kur Arbnor Ramadani ka realizuar nga pika e bardhë. Dukagjini ka rikthyer epërsinë në minutën e 54-t, me Egzon Sinanin që ka shënuar për 2:1. Ky rezultat ka mbetur në fuqi deri në fund të takimit, duke i siguruar skuadrës nga Klina tri pikë të rëndësishme.

Për Dukagjinin kjo ka qenë fitorja e dytë e sezonit, krahas dy barazimeve, duke e çuar skuadrën në kuotën e tetë pikëve pas katër xhirove. Në anën tjetër, situata vazhdon të jetë e vështirë për Llapin, i cili mbetet pa pikë pas katër ndeshjeve të para të kampionatit, me katër humbje radhazi. Kujtojmë se sot (e martë) do të luhen dy ndeshje të xhiros së pestë të Superligës së Kosovës në futboll. Drenica - Prishtina dhe Vushtrria - Llapi janë duelet që do të luhen nga ora 16:00.

SONTE NIS FAZA E LIGËS NË CHAMPIONS, DY NDESHJE HAPIN XHIRON E PARË



PRISHTINË, 7 SHTATOR - Sezoni 2026/27 i Ligës së Kampionëve, saktësisht fazës së ligës, nis zyrtarisht sonte (e martë). Në fakt, ndeshjet e xhiros së parë të kësaj faze do të zhvillohen sot (e martë),

nesër (e mërkurë) dhe pasnesër (e enjte). Megjithatë, xhiroja e parë nis me dy ndeshjet e sonte: AEK Athina - LASK dhe Club Brugge - Aston Villa. Të dyja këto ndeshje nisin nga ora

18:45 pasi katër duelet e tjera të së martës mbrëma do të nisin nga ora 21:00. Borussia Dortmund - Villarreal, Porto - Manchester City, Lille - Real Betis dhe Real Madrid - Inter, janë përballjet e së martës

mbrëma. Ndërkohë, nga gjashtë ndeshje të xhiros së parë do të luhen nesër dhe pasnesër, ku në total për këto tri ditë do të zhvillohen 18 përballje të Ligës së Kamionëve.

Fiorentina shkarkon trajnerin Grosso

FLORENCE, 7 SHTATOR - Fabio Grosso i Fiorentinas është bërë trajneri i parë i shkarkuar në sezonin 2026/27 në pesë ligat kryesore të futbollit në Evropë. Grosso është shkarkuar nga pozita e trajnerit, pasi

Fiorentina i ka humbur tri ndeshjet e para të këtij sezoni në Serinë A të Italisë. Fiorentina këtë vit feston 100-vjetorin e themelimit të klubit, ndërsa aktualisht renditet në pozitën e fundit në tabelë, pa

asnjë pikë. Skuadra e Fiorentinas është mposhtur në xhiron e tretë, në shtëpi, nga Torino me rezultat 2:1, ndërsa më herët ka pësuar humbje edhe nga Roma dhe Frosinone. Drejtuesit e klubit

tashmë janë duke punuar për gjetjen e trajnerit të ri, i cili pritet të paraqitet para ndeshjes së radhës kundër Venezias në udhëtim, të cilën Fiorentina do ta zhvillojë këtë të premte.



DEBAT PUBLIK

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook


www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.
- Trim Rezniciq shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shff.m.u “Ahmet Rustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Haidar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

